



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:234365

Datë: 21.12.2023

Numri i dokumentit: 05108789

P.nr.2989/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i përgjithshëm- Divizioni Penal, me gjyqtarin Ertan Sejfulla, me praktikanten Fahrije Ademi, në çështjen penale kundër të pandehurit Rr.K, për shkak të veprës penale Lëndim i lehte trupor nga neni 185 par 1, nenpar.1.4 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.4253/21, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, më dt.24.11.2023, jashtë seancës, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr. 4253/2021 e dt.20.10.2021 dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri: RR.K, nga babai, nena, e gjinisë, i lindur më, ne, me vendbanim ne rr.”.....”nr, ne, i, i, me nr. personal: shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

S e p s e:

Me date 22.07.2021, ne ora 19:15, ne rr.”.....”, ne, i pandehuri me qellim te shkakimit te lëndimit trupor, për shkak te mosmarrëveshje te atëçastshme për një ulëse ne autobus, e ka sulmuar fizikisht te dëmtuarin L.P, duke e goditur me grushte ne koke, për çka i njëjti ka pësuar lëndim gërvishtje pranë laprës se veshit te majte te shkaktuara nga veprimi

mekanik i mjetit te forte mprehtës (jo i mprehtë i topitur) e qe si te tilla bëjnë pjese ne lëndime te lehta trupore me pasoja te përkohshme për shëndetin,-

- Me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehte trupor nga neni 185 par 1, nenpar 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata në bazë të neneve 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69 të KPRK, si dhe neneve 364 dhe 495, të KPPK-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

- Dënim me gjobë në shumën **300.00 (treqind) €**, të cilin dënim i pandehuri obligohet ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. I njëjti dënimin e shqiptuar mund të paguajë, me dy këste me se largu deri me datën 20 të muajit vijues. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë.
- Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata dënimin me gjobë në bazë të nenit 43 par 3 të KPRK-së, do ta zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.
- Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale dhe atë për paushallin gjyqësor në shumë prej 30.00 (tridhjetë) €, në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej 20.00 (njëzet) €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Pala e dëmtuar L.P, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.4253/2021, ndaj të pandehurit Rr.K, për shkak të veprës penale Lëndimi i lehte trupor nga neni 185 par 1 nenpar 1.4 të KPRK-së, dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimor, me arsyetimin së ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se i pandehuri vërtetë e ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjykata pasi shqyrtoi përmbajtjen e aktakuzës dhe kërkesës për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor nga ana e organit të ndjekjes, gjeti se të njëjtat janë përpiluar në përputhje me nenin 493 te KPPRK-së, andaj erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet nga neni 495 i KPPRK-së, që në këtë çështje penale pa u mbajtur fare shqyrtimi gjyqësor të marrë vendim për shqiptimin e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se në bazë të raportit fillestar të incidentit 2021-AC-1001 i dt.22.07.2021, raporti i ekspertit mjeko-ligjor të dt.21.09.2021, deklaratave të dëshmitarëve si dhe në bazë të dokumentacionit me shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata konstaton se i pandehuri, është penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale Lëndimi i lehte trupor nga neni 185 par 1 nën par 1.4 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë elementet e kësaj vepre penale.

Gjykata vlerësoj se edhe me këtë dënim të shqiptuar do të arrihet qellim i dënimit në vështrim të nenit 38 të KPRK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre, që në të ardhmen i pandehuri të ketë kujdes të shtuar që të mos bie në kundërshtim me ligjin, si dhe me këtë dënim shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer dhe ngrit moralin dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPPRK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë të Ligjit nr.08/L-109.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 364 e 495, të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal

P.nr.2989/21 të dt.21.12.2023

Gjyqtari,
Ertan Sejfulla

KËSHILLË JURIDIKE:

I pandehuri ose mbrojtësi i tij, në afat prej tetë (8) ditëve, pas pranimit të këtij aktgjykimi-urdhri ndëshkimorë, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë.